



DOKUMENT PËR POLITIKA PUBLIKE

STATUSI DHE NEVOJAT E KORRESPONDENTËVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT



Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

DOKUMENT PËR POLITIKA PUBLIKE

STATUSI DHE NEVOJAT E KORRESPONDENTËVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Dragan Sekullovski, Drejtor i projektit

Gusht 2019

Ky publikim është përgaditur në kuadër të projektit "Gazetarë të sigurtë për informacione të besueshme në Maqedoni", mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Shkup. Përmbytja e publikimit është përgjegjësi vetëm e SHGM-së dhe e autorëve dhe në asnjë rast nuk mund të konsiderohet se reflektojnë qëndrimin e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Shkup.

Botues: Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

Gradski zid blok 13, 1000 Skopje, Republika e Maqedonisë së Veriut
Tel: 00389 (02) 3298-139 e-mail: contact@znm.org.mk

I. HYRJJE

Mediat dhe gazetaria në Republikën e Maqedonisë së Veriut përballen me sfida të ndryshme. Trendet aktuale në hapësirën mediatike në Republikën e Maqedonisë së Veriut vazhdojnë të jenë shumë të palakmueshme. Gjatë dekadës së kaluar, gazetaria ishte në gjendje kritike në më shumë aspekte, ndërsa kjo ndikoi në përkeqësimin e gjendjes së korrespondentëve – gazetarë nga periferia e vendit.

Me ndryshimin e teknologjise informative, pritet, kjo gjendje të zhvillohet në drejtim të trendeve të reja në media, që do të zhvillohen intensivisht. Kjo do të thotë se mjedisi digjital do të kontribuojë për ndryshimin e formatit të mediave dhe të shprehive të publikut për zbatimin e tyre.

Në këtë proces të rëndësishëm për të mos u cënuar qëllimi themelor i mediave, për të qenë servis publik – informues dhe roje të demokracisë në shoqëri – në nivelin qendror, por, edhe në nivelin vendor. Mediat kanë detyrim në mënyrë të përgjegjshme dhe të vetëdijshme ta ushtrojnë rolin informativ dhe edukativ. Kjo do të thotë se gazetaria është faktori kryesor për ruajtjen e baraspeshës midis pikpamjeve të ndryshme në media të ndryshme, si dhe ta ruaj sigurinë në kushte socio-ekonomike dhe të realitetit kulturor në shoqërinë bashkëkohore.

Me qëllim për të krijuar zhvillim të qëndrueshëm në sferën e mediave, por edhe të detektohen çështjet kryesore në veprimatrinë e mediave, kemi përgatitur një analizë për gjendjen e mediave dhe të gazetarisë me rekomandime konkrete, të cilat kontribuojnë për përmirësimin e gjendjes socio-ekonomike të korrespondentëve dhe për forcimin e rrjetit të korespondentëve, me të vetmin qëllim kënaqjen e nevojave të opinionit publik për temat me interes lokal publik.

Për nevojat e këtij dokumenti për politikat publike, SHGM shfrytëzoi të dhëna nga analizat e anëtarëve të Shoqatës, por edhe nga subjekte tjera relevante, të cilët merren me këtë gjendje në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në vende të tjera, me qëllim të mblidhen të dhëna esenciale dhe gjithëpërf-

shirëse dhe informacione për situatën. Përveç kësaj, janë shfrytëzuar edhe përgjigjet nga shkesat e dërguara deri te servisi publik dhe të një pjese të mediave private në pajtim me Ligjin për qasje të lirë në informatat me karakter publik.

II. ANALIZA E SITUATËS

Rrejti i korrespondentëve të servisit radioviziv publik, por edhe të televizioneve kombëtare vazhdimisht zvogëlohet, ndërsa në disa media tërësisht është shpërbë. Mediat kombëtare ndieshëm raportojnë në mënyrë të centralizuar dhe thuaja nuk mbulojnë tema me rëndësi lokale. Në këtë mënyrë, opinioni nuk ka pasqyrë të plotë për gjendjen shoqërore dhe proceset në vend. Gjatë viteve të kaluara situata u përshkallëzua në nivele shumë të ulta, për këtë dëshmon vendimi, që për shkaqe financiare, të mos ndahet shpërblimi "Mende Petkovski", i cili ndahet për të valorizuar punën e korrespondentëve dhe ndahet në përkujtim të gazetarit të njohur nga Manastiri, i cili vdiq në vitin 2005.

Financat janë problem kryesor i korrespondentëve. Të gjitha hulumtimet e deritashme për gjendjen socio-ekonomike të korrespondentëve tregojnë se kompensimet mujore ose honoraret për një shkrim të botuar ose kontribut të emituar nuk mund t'i mbulojë shpenzimet elementare të jetesës. Hulumtumi më i ri për gjendjen e korrespondentëve në Maqedoninë Lindore tregoi se thuaja 54 për qind e gazetarëve marrin paga midis 11 mijë deri 16 mijë denarë, 11 për qind e gazetarëve kanë pagë mujore prej 8 deri 10 mijë denarë, që vertetë është shumë dëshpruese. Vetëm 10,2 për qind e gazetarëve kanë paga mujore mbi 22 mijë denarë.

Një pjesë e korrespondentëve që nuk mund të përdorin resurset e mediave lokale, janë të detyruar të shpenzojnë honorarin e tyre me kameramanin ose fotoreporterin, sepse mediat kombëtare thuaja kurrë nuk mbulojnë këto shpenzime.

Kjo gjendje është dëshpruese dhe ndikon në demotivimin e gazetarëve, ndërsa reflekton edhe mbi cilësinë e informimit.

RTM gjatë 24 orëve, emiton 73 orë programe për nevojat e tre kanalve të saj dhe të Kanalit në satelit, edhe atë:

Në kanalin e parë (RTM1) emiton program 24 orësh;

Në kanalin e dytë (RTM2) emiton program 24 orësh në gjuhët e pakicave, edhe atë në gjuhën shqipe, turke, serbe, rome, vllehe dhe boshnjake;

Në kanalin parlamentar;

Në kanalin e satelitit; (MRTsat) emiton program 24 orësh;

Si dhe në tre radiostacione: Radio moaqedone kanali i Parë, i Dytë dhe i Tretë.

Me ndryshimet e Ligjit për shërbimet mediatike audio dhe audiovizive, RTM është e obliguar të hapë edhe një kanal 24 orësh me program në gjuhën shqipe, duke shtuar numrin e TV kanaleve në pesë, që do të ketë reperkusione finansiare ndaj punës së saj.


Reformat në servisiv radioviziv publik janë pjesërisht të kushtëzuara edhe nga rritja e buxhetit të tij, si dhe nga zgjedhja e anëtarëve të ri në Këshillin programor, ndërsa ata duhet të jenë kuadro kompetentë dhe apartiak. Në këtë mënyrë, RTM do të plotësojë misionin e tij për të informuar, edukuar dhe zbavitur qytetarët. Ky qëndrim është përsëritur disa herë nga SHGM, dhe organizatat e tjera të mediave, si dhe nga një pjesë e ekspertëve. Puna e RTM është rregulluar me dokumenta interne, Statusin, Ligjin për shërbimet mediatike audio dhe audiovizive dhe me Ligjin për media.

Sipas raportit vjetor të RTM për vitin 2017 (shiko infogramin 1), buxheti i tij është 16,869,798 euro, prej të cililit 37 për qind janë të dedikuara për pagat e nëpunësve.¹ Në një bisedë me një anëtarë të

¹ Raporti vjetor i RTM për vitin 2017: [www.http://mrt.com.mk/sites/default/files/Консолидиран_годишен_финансиски_извештај_ЈПП_МРТ_2017г.pdf](http://mrt.com.mk/sites/default/files/Консолидиран_годишен_финансиски_извештај_ЈПП_МРТ_2017г.pdf)

Këshillit programor të RTM, na është thënë se aktualisht RTM ka punësuar 12 korespondent, të cilët punojnë për RTM1 dhe RTM2, dhe se këtë vit ajo ka shpalluar konkurs për punësimin e korespondentëve të ri. Megjithatë, ky numër është shumë i ulët, nëse merret parasysh se do të lëshohet në përdorim edhe një kanal televiziv me program në gjuhën shqipe.

Infografikon 1: Të dhënat themelore për RTVM



Agjencia shtetërore e lajmeve (MIA), si, servis zyrtar publik informativ, është formuar në vitin 1998, me vendim të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. Ajo prodhon midis 300 dhe 350 kontribute në ditë dhe i shpërndanë përmes postës elektronike dhe njëkohësisht i vendos në ueb faqen e saj të internetit. Servisi punon nga ora 7 e mëngjesit e deri në mesnatë dhe raporton në gjuhën maqedone, shqipe dhe angleze. Përveç kësaj, ka rreth tridhjetë korespondentë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe jashtë vendit, ndërsa disponon edhe me 80 të punësuar, prej të cilëve 30 korespondentë lokal dhe jashtë vendit.

III. KRAHASIMI I GJENDJES ME RRJETIN E KORRESPONDENTËVE NË AGJENCINË E LAJMËVE - MIA

Për qëllimet e këtij hulumtimi, sipas Ligjit për qasje të lirë në informatat me karakter publik, siguroam të dhëna për gjendjen e rrjetit të korrespondentëve në agjencinë shtetërore të lajmeve.

KORRESPONDENTË NË VITIN 2005

Korrespondentë nga periferia e vendit: Gjithsej dhjetë, prej të cilëve tetë me marrëveshje për angazhim të përkohshëm dhe honanari i tyre sillej prej 2000 deri në 13 000 mijë denarë, ndërsa ka vetëm dy të punësuar me marrëveshje për kohë ta pacaktuar dhe paga e tyre sillet prej 18.000 deri në 20.000 denarë

Korrespondentët në vendet e huaja: Vetëm një korrespondent në Londër me marrëveshje për angazhim të përkohshëm dhe honorari i tij ishte 10 mijë denarë.

KORRESPONDENTË NË VITIN 2009

Korrespondentë nga periferia e vendit: Gjithsej 15, prej të cilëve me marrëveshje për angazhim të përkohshëm dhe honorari i tyre ishte 200 denarë për një lajmë të publikuar, por kompensimi mujor mund të ishte maksimum deri 8 mijë denarë. Vetëm dy korrespondentë ishin të punësuar me marrëveshje për kohë të pacaktuar dhe paga e tyre ishte 24 mijë denarë.

Korrespondentë në vendet e huaja: Gjithsej tre korrespondentë, të gjithë me marrëveshje për angazhim të përkohshëm. Korrespondenti në Londër kishte

honorar prej 15 mijë denarësh, korrespondenti në Pragë kishte honorar prej 12 mijë denarësh dhe korrespondenti në Suedi kishte 9 mijë denarë honorar.

KORRESPONDENTË NË VITIN 2019 (MAJ 2019)

Korrespondentë nga periferia e vendit: Gjithsej 17, prej të cilëve 9 me marrëveshje për angazhim të përkohshëm dhe honorari i tyre ishte 200 denarë për një lajmë të botuar. Dhe 8 korrespondentë të punësuar për kohë të pacaktuar, ndërsa paga e tyre është midis 9 mijë deri 25 mijë denarë.

Korrespondentë në vendet e huaja: Gjithsej 5, prej të cilëve 3 me marrëveshje për angazhim të përkohshëm, 1 me marrëveshje me kohë të pacaktuar dhe një të punësuar me marrëveshje në kohë të pacaktuar. Korrespondenti në SHBA është angazhuar me marrëveshje si këshilltar për shërbime të korrespondenturës dhe honorari i tij mujor është 50.050 denarë. Me marrëveshje të njejta janë të angazhuar edhe korrespondentët në Kosovë, Beograd, të dy më një honorar mujor prej 24.600 denarë. Korrespondenti në Bruksel është angazhuar me marrëveshje për kohë të caktuar, ndërsa honorari i tij mujor është 17 mijë denarë, plus 2000 euro kompensim terreni. Vetëm korrespondenti në Athinë është i punësuar me marrëveshje të pacaktuar dhe paga e tij është 21.600 denarë, plus 1000 euro kompesim terreni.

Sipas analizave, për cilësinë e informimit të RTM dhe MIA nevojitet të vendoset rrjetë i zhvilluar korrespondentësh, e cila do të përfshijë të gjitha 30 mjediset urbane në vend. Prej 150 mijë banorësh, sa ka në rajonin lindor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, RTM ka punësuar vetëm tre korrespondentë dhe nuk ka asnjë qendër korrespondenture aktive.

IV. HULUMTUM ANKETË PËR GJENDJEN E KORRESPONDENTËVE NË VEND

Rezultatet e fituara nga hulumtimi përmes anketës janë dëshpruese për gazetarinë. Të rrallë janë gazetarët, të cilët janë të kënaqur me të ardhurat e tyre mujore, edhe pse, me rëndësi është të thekoshet se për t'i fituar ato të ardhura janë të detyruar të punojnë në dy ose tre vende njëkohësisht.

1. MARRËVESHJE ME KOHË TË PACAKTGUAR OSE MARRËVESHJE PËR HONORAR

Të rrallë janë korrespondentët në media kombëtare që kanë marrëveshje pune me kohë të pacaktuar. Të gjithë gazetarët e anketuar, pajtohen se korrespondentët nuk janë të pavaruar financiarisht. Korrespondenti i MIA është njëri nga të rrallët me marrëveshje për punësim të përhershëm.

"Punoj në MIA me marrëveshje për punësim të përhershëm, ndërsa më përpara punoja me honorar për më shumë media kombëtare: TV Telma, TV Alsat-M, gazeta "Utrinski vesnik", "Dnevnik", "Radio Evropa e Lirë", dhe të tjera. Korrespondentët nuk janë të pavarur financiarisht, veçanërisht ata që janë të angazhuar me honorar", thotë korrespondenti i Agjencisë shtetërore të lajmeve, MIA.

Pozitive është që një pjesë e portaleve të internetit tregojnë interes për të ndjekur tema nga brendia e vendit dhe angazhojnë korespondentë, por marrëveshjet e tyre nuk janë të afatizuara dhe janë të angazhuar me honorar.

"Për momentin jam i angazhuar me honorar si korrespondent në dy media online. Kam marrëveshje për bashkëpunim me honorar në kuadër të një projekti. Mbulojë ngjarrje nga të gjitha fushat në Manastir, Resnjë, Demir Hisar, Novaci dhe Mogillë. Në vitin 2000 nisa të punojë në TV Orbis në Manastir. Tre vite pa asnjë ditë stazh pune, edhe pse isha redaktor, gazetar, drejtues emisioni. Na paguante aq sa do bënim kontribute. Një kontribut pa kokën e lajmit paguheshte 50 denarë, me deklaratë 100 denarë, me dy deklarata

“

150 denarë, etj. Pastaj dhjetë vite punova në Javoren lokale "Javnost", prej të cilëve vetëm tre vite me kontribute të paguara dhe pastaj me orar të shkurtuar pune. Njëkohësisht prej vitit 2005 e deri në vitin 2017 isha korrespondent i gazetës "Dnevnik", e angazhuar me honorar, pa pagë dhe kontribute. Prej vitit 2012 e deri në vitin 2016 isha korrespondent i gazetës ditore Vest. Ndërsa prej vitit 2015 e deri në vitin 2017 edhe i gazetës "Utrinski vesnik", e angazhuar, poashtu, me marrëveshje për honorar. Prej vitit 2001 deri tani jam korrespondent i Radios Evropa e Lirë me marrëveshje si frilens", thotë një korrespondente nga Manastiri.

”

2. NDJENJA E PASIGURISË PËR TË ARDHMEN

Shuma e parave që i marrin korrespondentët janë nën mesataren në nivel shteti, problem shumë i madhë për gazetarët është edhe fakti se nuk kanë sigurim shëndetësor dhe pensional dhe nuk u ec stazhi i punës. Kjo gjendje krijon ndjenjën e pasigurisë për të ardhmen dhe kontribuon që një numër i madhë i gazetarëve ta braktisin profesionin e tyre dhe të punojnë në veprimtari të tjera.

“

"Për finansat nuk do të flas personalisht, sepse nuk guxojë t'i publikojë të dhënat. Por, mund të them se jam ndër korrespondentët me honorar më të lartë, po pa kontribute të paguara. Korrespondentët e tjerë të Manastirit marrin prej 10 mijë deri më 18 mijë denarë honorar mujor. Prej tetë korrespondentëve aq sa jemi aktualisht, vetëm tre kanë marrëdhënie të rregullt pune, korrespondenti i MIA, RTM dhe i gazetës Nova Makedonija. Lidhur me pavarësinë financiare, mund të them se zvogëlimi i numrit të korrespondentëve sepse më herët kishte më shumë korrespondentë dhe me honorare me të larta, pavarësia financiare ishte më e madhe. Me uljen e honorareve dhe duke mos zgjidhur me vite marrëdhënien e punës, gazetarët nga brendia e vendit janë të detyruar të punojnë edhe në ndonjë medium lokal. Në këtë rast shpeshherë politikat e medias lokale nuk përputhen me politikën editoriale të medias kombëtare, prandaj gazetari për të mos ngelur pa para, sepse prej të gjitha vendeve kur të mblidhen honoraret bashkë bëjnë një pagë mesatare me arsim të lartë, është i detyruar t'i injorojë disa tema problematike. Ka pasur raste kur për shkak të teksteve në mediat kombëtare të humbet vendi i punës në nivel lokal. Do të

”

“

thotë se për çfarë pavarësie mund të flasim me media që me vite shfrytëzojnë shërbimet e korrespondentëve pas mos i paguar kontributet për pension dhe shëndetësi? Gazetarët këtu mbajnë etiketën e mediave për të cilat punojnë, dhe pastaj kur do të pushohen nga puna për shkak të shkurtimeve të vendeve të punës, të cilat zakonisht nisin prej korrespondentëve, ose kur mbyllet mediat, gazetarët mbesin edhe pa honorar, ndërsa për të hyrë në ndonjë media lokale duhet ti përshtaten pushtetit, pa dallim se kush është ai. Nëse jo, nuk ka bukë për ju"- thotë Zhaneta Zdravkovska, korrespondente nga Manastiri.

”

Gjendja alarmante është në të gjitha rajonet e vendit. Edhe korrespondentët e Maqedonisë Perendimore thonë se honoraret ose fitimet mujore që vijnë nga mediat kombëtare janë të pamjaftueshme për mbulimin e nevojave themelore për një jetë dinjitoze.

“

"Kam punuar në radio lokale dhe televizion, me marrëveshje për kohë të pacaktuar, po kam punuar edhe si korrespondent për Televizionin TV 24 Vesti, si dhe për Agjencinë e lajmeve, Meta. Marrëveshjet ishin të lidhura për një honorar mujor, pa punësim. Në asnjë rast korrespondentët nuk janë ta pavarur financiarisht. Mjetet ndryshojnë nga një medium te tjetri, por zakonisht honoraret janë të ulta. Për shembull, ose punohet me copë, respektivisht për një kontrubut paguhesh 500 denarë, ose për një shumë fikse mujore, e cila sipas, përvojës time personale, nuk ka kaluar shumë e gjashtë mijë denarëve. Nëse korrespondenti nuk ka edhe një punë tjetër, nga mjetet e fituara si korrespondent, nuk mund t'i kënaq as nevojat më elementare", thotë një korrespondent nga Tetova.

”

Shqetëson fakti se edhe këto korrespondent, që me vite kanë punuar për median e njejtë kombëtare, nuk kanë fituar ndonjë marrëveshje më të mirë pune, respektivisht punëdhënësi nuk paguan kontrubutet dhe nuk kanë kurrëfarë sigurimi social.

“

"Jam i angazhuar në TV Sitel, me marrëveshje për honorar. I mbulojë qytetet nga rajoni Lindor dhe Sveti Nikole. TV Sitel është shtëpia e parë mediatike me të cilën kam marrëveshje për honorar, prej vitit

”

“

2008. Paguhet sipas normës, 800 denarë për kontribut... gazetarët nuk janë të pavarur financiarisht për shkak të pagave të ulta, ndërsa nga ana tjetër, mediat kombëtare kanë kërkesa të mëdha prej tyre", thotë një korrespondent nga Shtipi.

”

3. MUNGESA E PAJISES PËR PUNË

Të rralla janë mediat kombëtare që sigurojnë pajisje adekuate dhe resurse të përshtatshme për korrespondentët për përmbushjen e obligimeve të tyre profesionale. Mungesa e pajisjes për punë në mënyrë shtesë ua rëndon punën korrespondentëve. Në fakt, gazetarët nga brendia e vendit, shpeshherë i shfrytëzojnë mediat lokale gjatë përgaditjes së kontributeve të tyre, ndërsa jo rrallë janë të detyrur honorarin e tyre ta ndajnë me kameramanin.

Në anketën e njejtë hulmtuese asnjë korrespondent nuk u përgjigjë pozitivisht në pyetjen nëse redaksitë u sigurojnë pajisje adekuate për raportim nga ngjarrjet me risk të lartë. Gjysma e të anketuarve u përgjigjen se pajisje për raportim prej ngjarrjeve me risk të lartë kanë marrë nga SHGM, por jo edhe prej mediave ku punojnë, ndërsa gjysma tjetër e të anketuarve vazhdojnë të punojnë pa pajisje adekuate mbrojtjeje. Përgjigje të ngjashme dhanë edhe në pyetjen nëse redaksitë kanë siguruar trajnime për raportim nga ngjarrjet me risk të lartë.

“

"Çdo ditë fotografoj vetëm, por kur kam nevojë për fotografi më cilësore për ndonjë temë më serioze, me dërgojnë fotoreporter profesional prej Shkupit. Lidhur me pajisjen, celularin ma ka siguruar redaksia dhe më paguan llogarin e telefonit dhe internetin. Por, ka media që shumë pak paguajnë honorar për shërbimet e kameramanit, prandaj është çështje kohe kur gazetarët do të ngelin pa kameraman. Duke mos mundur të gjejnë kameraman që do të pranajnë të punojnë për honorar prej 10 mijë denarësh, gazetarët do të jenë të detyruar ose vetë të inçizojnë ose të heqin dorë nga puna e korrespondentit"-, thotë një korrespondente nga Manastiri.

”

Kjo gjendje, sipas dëshmimeve të të anketuarve, ndikojnë edhe në raportet kolegjiale dhe në cilësinë e punës së kryer.

"Për përgaditjen e kontributeve janë përdorur materialet e televizioneve amë për të cilën gazetari punon si korrespondent. E njejtja gjë vlenë edhe për kameramanët – ka panuar ai që është i punësuar në televizionin lokal prej ku raporton gazetari, prandaj çdoherë ka pasur konflikte, përveç nëse arrihet ndonjë marrëveshje midis gazetarit dhe kameramanit për ndarjen e fitimit. Poashtu, sa i përket pajisjes për raportim prej ngjarrjeve me risk të lartë, asnjë prej mediave për të cilat kam punuar si korrespondent nuk më ka siguruar këtë lloj pajisjesh, e as që kemi pasur trajnime për raportim prej këtyre ngjarrjeve"-, thotë një korrespondente nga Tetova.

"Kameraman nuk kam dhe kurrë nuk ka qenë i angazhuar, ndërsa para 8 muajsh më kanë siguruar pajisje për punë. Nuk kam pajisje për raportim prej ngjarrjeve me risk të lartë. Media nuk më ka siguruar as trajnim për raportim prej këtyre ngjarrjeve"-, thotë korrespondenti i TV Sitel prej Shtipi dhe Sveti Nikoles.

4. PRESIONE PREJ QENDRAVE TË NDRYSHME TË PUSHTETIT

Sipas raportit të hulumtimit të bërë, rezultatet tregojë se gazetarët janë shumë të dëshpruar kur flitet për rezistencën ndaj trysnive, ajo shkon deri atje derisa disa korrespondent, të vetëdijshëm për gjendjen në media, as që presin të kenë një mbrojtje të tillë prej medias për të cilin punojnë.

"Deri tani jam mbrojtur vetë dhe nuk ka nevojë këtë ta bëjë mediumi. Mbrohem duke respektuar plotësisht Kodin etik të SHGM dhe normat etike"-, thotë korrespondenti i MIA.

Presionet dhe përpjekjet për të bërë presion vazhdimisht vijnë nga qendra të ndryshme të ndikimit. Pushohen nga puna dhe degradohen gazetarë për shkak të ndikimit që kanë ndaj pronarëve të mediave strukturat e politikës dhe të biznesit.

"Aktualisht nuk përballem me presione. Por, patjetër duhet të përmend rastin kur në vitin 2012 punoja për gazetën "Javnost" dhe isha e paraqitur në Entin e punësimit, përnjëherë për pesë minuta u pushova nga puna sepse pronarit të gazetarën nuk i shkonte për shtati teksti që si korrespondent e kisha botuar në gazetën "Vest", lidhur me padinë që familjarët e Manakit kundër kryetarit të komunës. Artikulli ishte i shkruar në mënyrë profesionale dhe u kishte dhënë mundësi të gjitha palëve ta thonë të vërtetën e tyre, mirëpo kryetari i komunës e mori në telefon pronarin e gazetës dhe ai më pushoi nga puna. Tani nuk kam problem, por paraprakisht kur kam pasur probleme me qendra të ndryshme të pushtetit dhe redaksitë nuk kanë bërë asgjë për të më mbrojtur. Kështu, nuk më kujtohet saktë cili vit ishte, besoj 2010, kur kryetari i Manastirit, Vlladimir Talevski në komemoracionin për Hebrejëte akuzoi Evropën sa ndaj Maqedonisë po bënë holokaust si fashistët ndaj Hebrenjëve. Këtë deklaratë e transmetuam në "Dnevnik", kolegja në "Utrinski Vesnik", dhe një kolegë tjetër i një televizioni. Kur u ngrit tensioni, ditën tjetër Talevski kontaktoi "gazetën "Dnevnik" duke u ankuar se e kisha nxjerrur nga konteksti. Dhe kolegët e gazetës në Shkup e botuan reagimin e tij, në të njëjtën gazetë, ku një ditë më parë në ballinë doli shkrimi me titullin Talevski me holokaustin prej BE-së. Për deklaratën e tij kishte edhe video, por kujt i interesonte e vërteta? Vetë media që na e botoi lajmin, ditën tjetër del kundër nesh, edhe pse keni transmetuar një të vërtetë. Përveç kësaj, Talevski një media tjetër lokale detyroi që në ballinë të botojë një artikull me titull "Talevski do t'i padisë gazetarët për të pavërtetën". Padi nuk ngriti, por u shfrytëzuan metoda për presion, ndërsa redaksia u përkul"-, thotë korrespondentja nga Manastiri.

Një pjesë e korrespondentëve thonë se nuk janë përballur me presione të ngjashme, por varësia financiare, respektivisht kërkesat shumë të mëdha të mediave për një honorar të vogël e vlerësojnë si presion të drejtpërdrejtë.

5. NDRYSHIME TË SHPESHTA TË POLITIKAVE EDITORIALE

Ndaj politikës editoriale ndikojnë shumë faktor shoqëror, mirëpo, korrespondentët problemin më të madhë e locojnë në raportet midis mediave dhe qendrave me ndikim politik. Mediat e mbyllura kishin ndikim të madhë dhe të drejtpërdrejtë në uljen e numrit të korrespondentëve, por gjendjen ndieshëm e përkeqësuan edhe mediat, të cilët brenda natës ndryshuan politikat editoriale.

"Numri i korrespondentëve varet nga mediat, ndërsa ulja e numrit të tyre do të thotë edhe më pak informim për publikun për ngjarjet në pjesët e tjera të vendit bile edhe bie edhe lexueshmëria dhe shikueshmëria e mediave. Ulja e numrit të korrespondentëve varet nga mbyllja e mediave të shtypura, por edhe prej asaj se shumë televizione kombëtare, pas ndryshimit të pushtetit ndryshuan edhe poplitikën e tyre editorial dhe debuan korrespondentët"-, thotë korrespondenti i MIA nga Strumica.

"Ulja e numrit të korrespondentëve ndikon negativisht ndaj nevojës së publikut për tu informuar. Informacionet janë të centralizuara vetëm në kryeqytet dhe politikën ditore. Ndiesshëm ka rënë raportimi prej rajoneve tjera të vendit, duke shkaktuar efektin e izolimit të këtyre rajoneve. Arsyja kryesore për uljen e numrit të korrespondentëve janë të ardhurat e ulta, mungesa e pajisjes së punës dhe shpeshherë keqpërdorimet e punëdhënësve"-, thotë korrespondentja nga Tetova.

"Mediat arsyetohen se nuk kanë mjete të mjaftueshme për rrjetin e korrespondentëve, ndërsa në të njëjtën kohë shtojnë numrin e njerëzve në deks dhe të gazetarëve në Shkup", thotë një korrespondent nga Shtipi.

6. DECENTRALIZIMI I LAJMEVE

Qëndrimet dhe përvojat për shkaktarët dhe fajtorët e kësaj gjendje janë të ndryshme, por korrespondentët janë të prerë dhe në një mendje në qëndrimin se duhet të bëhen ligje, të cilat do të obligojnë pronarët e mediave të angazhojnë korrespondentë nga brendia e vendit. Sipas gazetarëve lokal, është e nevojshme të angazhohen korrespondent prej çdo qyteti më të madhë për të përmirësuar gjendjen dhe opinioni në mënyrë të përshtatshme të jetë e informuar për gjendjen në mbarë vendin.

“

"E para, duhet legjislacion, çdo medium me koncesion kombëtarë- medium elektronik dhe media të shtypura në mbarë vendin, të ketë patjetër një numër të caktuar të korrespondentëve, të paktën prej qyteteve më të mëdha. Mediat duhet të pushojnë gazetarët nga periferia e vendit t'i shikojnë vetëm si korrespondentë, por para së gjithash duhet t'i shikojnë si gazetarë dhe si antarë të barabartë të redaksive. Dhe nuk mjafton vetëm të angazhohen korrespondentë nga rajone të ndryshme, por edhe prej çdo qyteti më të madhë"-, thotë korrespondenti i MIA.

"Të zhgjedhin kuadro cilësorë prej më shumë qyteteve të vendit. T'i punësojnë! Rregullisht të marrin pagat! T'i njoftojnë për politikën editoriale dhe ndryshimin eventuale të saj. T'i trajnojnë. T'i ftojnë të paktën njëherë në muaj në kolegjiun e redaksisë. Të vendosin një person përgjegjës për kontakt me korrespondentët dhe t'u japin hapësirë në edicionet e lajmeve, gazetave, portalet... nevojitet angazhimi i korrespondentëve nga të gjitha qytetet më të mëdha: Manastiri, Ohri, Tetova, Prilepi, Velesi, Shtipi, Kumanova, Strumica, Kavadari. Të mos mund medium të emitojë program në nivel kombëtarë, pa pasur rrjetë korrespondentësh"-, thotë një korrespondent, i cili dëshiron të mbetet anonim.

"Njëherë, duhet të angazhojnë njerëz të përshtatshëm për të kryer punën. T'u sigurojnë pajisje dhe paga solide. Në ato vende ku nuk ka kuadër profesional, të përpiqen t'i trajnojnë të interesuarit. Në fund, të sigurojnë hapësirë të mjaftueshme mediatike edhe për problemet rajonale dhe lokale, ku në fokus duhet të jenë qytetarët. Kuptohet se me

”

“

diat kombëtare duhet të kenë korrespondent nga secili rajon, prandaj janë media kombëtare. Duhet të mbulojnë tema nga të gjitha rajonet e vendit", thotë një korrespondent nga Tetova.

"Të investojnë më shumë mjete për të shtuar interesin edhe të gazetarëve të rinj të sapodiplomuar... sigurisht që mediat duhet të kenë korrespondent nga çdo rajon, veçanërisht servisi radiovizic publik për të cilin paguajmë të gjithë, ndërsa ne si media private u dërgojmë materiale... TURP..."-, thotë një korrespondent nga rajoni Lindor.

”

Korrespondentët janë të ndarë nëse jashtë kryeqytetit ka kuadër të mjaftueshëm arsimor, i cili mund t'u përgjigjet nevojave për rritjen e numrit të korrespondentëve në të gjitha llojet e mediave.

“

"Në disa rajona ka kuadër, në disa nuk ka fare", thotë korrespondenti i MIA.

"Pikërisht për shkak të mbylljes së korrespondenturave dhe honorareve të ulta, por edhe të pagave të ulta në nivel lokal, nuk ka interes nga të rinjtë për profesionin e gazetarit. Nëse krijohet hapësirë dhe kushte më të mira, ky vakum do të plotësohej. Përndryshe, aktualisht ka gazetarë me përvojë punë mbi 30 vite, të cilët mund në mënyrë solide t'u përgjigjen të gjitha sfidave të punës"-, thotë një korrespondente nga Manastiri.

"Sinqerisht, nuk besoj. Besoj se numri i përgjithshëm i kuadrove të edukuar nga fusha e gazetarisë është i ulët. Kjo edhe më shumë shfaqet në nivel lokal. Por, mund të ndryshojë duke investuar në edukimin dhe me përpjekje serioze për përmirësimin e gjendjes."-, thotë një korrespondente nga Tetova.

"Nuk ka kuadër të mjaftueshëm gazetaresk, ndërsa edhe më pak kuadër teknik"-, vlerëson një korrespondent nga rajoni i Shtipit.

”

7. GJENDJA AKTUALE ME RRJETIN E KORRESPONDENTËVE NË RTM

Servisi i parë programor, RTM1

Aktualisht në Servisin e parë programor të RTM ka katër korrespondent me marrëdhënie të rregullt pune. Ato janë:

- Korrespondent në Beograd, Oliver Brankoviq;
- Korrespondent në Prilep, Elizabeta Mitrevska, (mbulon Krushevën, Krivogashtanin, Makedonski brodin dhe Dolnenin);
- Korrespondent në Manastir, Stevçe Mitrevski, mbulon edhe Demir Hisarin, Debarcën, Novacin dhe Mogillën);
- Korrespondent në Ohër, Sasho Nellovski, (mbulon edhe Strugën, Debarcën dhe Vevçanin).

Në Ohër dhe Manastir ka edhe kameraman me marrëdhënie të rregullt pune me të ardhura të rregullta prej 20.500 mijë denarësh dhe me kontribute të paguara.

Brankoviqi në Beograd dhe Nellovski në Ohër janë me vendime për vend pune "gazetar 1", me pagë mujore prej 27 mijë denarësh (pa stazhin). Mitrevska në Prilep dhe Mitrevski në Manastir janë me pozita "gazetar 2" me të ardhura mujore neto afër 23 mijë denarë. Këta korrespondent nuk marrin mjete shtesë për shpenzime tjera, përveç nga dy-tre mëditjeve mesatare, kur shpesh udhëtojnë në qytetete tjera që i mbulojnë, që mesatarisht nuk kalon shumë prej 2 mijë denarësh në vit.

"Gjendja para dy vitesh ishte më ndryshe. Atëherë kishte shtatë korrespondent të angazhuar me honorar dhe tre korrespondent jashtë vendit, me marrëdhënie të rregullt pune. Shtatë korrespondent, që ishin të angazhuar me honorar janë:

- Katerina Davçeva, korespondent në Strumicë dhe rajoni Juglindor;
- Olivera Zhezheva, korrespondent në Shtip dhe rajoni Lindor;
- Gabriella Dimkoviq, korrespondente në Kumanovë dhe rajoni Verilindor;
- Zoran Jovanovski, korrespondent në Tetovë dhe rajoni Veriperendimor;
- Janço Naumovski, korrespondent në Strugë (Vevçan, Dibër dhe rajoni i poshtëm i Rekës);
- Darko Shtargovski, korrespondent në Prilep dhe rajoni Jugoerendimor;
- Dijana Ivanova, korrespondent në Veles dhe rajoni i Vardarit.

Shuma e honorareve të këtyre korrespondentëve është prej 30.000 deri në 40 000 denarë, varësisht prej numrit të kontributeve, derisa gazetari në dorë i jep kameramanit prej 10.000 deri në 15.000 denarë. Kameramani përveç se ka inçizuar, shtesë, me pajisjen dhe makinën e tij edhe i monton kontributet".²

Jashtë vendit si korrespondent të RTM1 deri në vitin 2018 kanë qenë:

- Korrespondenti nga Brukseli, Marina Toneva me kameramanin Kire Tonev;
- Korrespondenti nga Athina, Marija Kotovska, me kameraman Borislav Stankoviq;
- Korrespondenti nga Uashingtoni, Irina Gelevska me kameramanin Risto Mishev.

RTM këtyre korrespondentëve u ka paguar shpenzimet për telefon, internet, qiranë e banesës, transport për qytetin ku kanë qëndruar dhe shpenzime të udhës nëse kanë udhtuar në qytete tjera, si dhe të ardhura për një "gazetar 1" me 27 mijë denarë dhe plus shtesa tjera që i ka përcaktuar menaxhmenti (shumat nuk janë të njohura).

² Intervistë me Donka Dolgoska, ish redaktor i redaksisë së korrespondentëve në RTM1, 31.5.2019.

"Gjendja aktuale me korrespondentët nuk mund të krahasohet me gjenjden para pesë, dhjetë apo 15 vitesh. Në periudhën para mbylljes së qendrave të korrespondenturave, RTM kishte korrespondent dhe kameraman me pajisje të plotë, zyra, makina zyrtare, paguheshin shpenzimet për benzinë dhe telefon, ndërsa kohë pas kohe ato kanë qenë edhe të shpërblyer".³

Aktualisht gjendja me pajisjen të këtyre pak korrespondenturave është sa vijon:

Manastir – ka kamerë të vogël "PANASONIC" dhe laptop që korrespondenti Mitrevski e ka siguruar nga sponzorët e komunës;

Prilep – korrespondentja Mitrevska vet inçizon me kamerë;

Ohri – korrespondenti nuk ka pajisje, me kameramanin, vitin e kaluar kanë marrë një kamerë të përdorur pa bateri, pastaj vetëm janë gjindur;

Beograd – inçizon vetëm, nuk ka kameraman.

"Korrespondentët nuk kanë makina zyrtare, i përdorin makinat e veta pa kompensim për karburantin dhe amortizimin, që nuk ishte rast para 15-20 vitesh. Elizabeta Mitrevska nga Prilepi, për shembull, nuk ka makinë personale dhe leviz në këmbë nëpër qytet, ndërsa në distanca më të gjata gjindet vetëm, shkon me taksì që e paguan vetëm prej xhepit ose shkon me kolegë të mediave të tjera dhe me makinat e tyre".⁴

Qendra të korrespondenturave të RTM nuk ekzistojnë prej vitit 2003 kur janë shuar. Atëherë korrespondentëve ua morën makinat zyrtare dhe pajisja tjetër. Prej vitit 2003 korrespondentët punojnë nga shtëpia. Dy vjet më vonë ajo nisi të merr nga 5 mijë denarë kompensim për shpenzime, që ishte hequr në vitin 2005.

³ Intervistë me Donka Dolgoska, ish redaktor i redaksisë së korrespondentëve në RTM1, 31.5.2019.

⁴ Intervistë me Donka Dolgoska, ish redaktor i redaksisë së korrespondentëve në RTM1, 31.5.2019.

Radio televizioni maqedon nuk ka asnjë korrespondent prej rajonit Lindor, Juglindor dhe Verilindor. Në këtë rajon nuk ka asnjë teknik, kameraman, mantazher. "Më herët, qendrat e korrespondenturave ishin të pajisura me studio, pasisje dhe kishim mundësi për inkuadrim të drejtpërdrejtë në programin e Radio televizionit maqedon. RTM ka 35 makina zyrtare, ndërsa prej tyre asnjë nuk është dhënë në përdorim në rajonet me interes për këtë hulumtim. Radio televizioni maqedon në këto rajone radiovizive nuk ka asnjë qëndër korrespondenture. Në pronësi të saj ka hapësira në Strumicë, në rrugën Mareshali Tito dhe në Shtip, në sheshin Liria, por nuk i përdor. Në Shtip, lokalet janë dhënë me qira dhe në vend të gazetarëve dhe kameramanëve, atje punojnë kuzhiner dhe kamarier, në një objekt hotelierie. RTM ka numrin më të madhë të të punësuarve në të gjitha mediat në Maqedoninë e Veriut, por Maqedoninë Lindore e mbulon me më pak të punësuar edhe se televizioni më i varfër lokal".⁵ (Stojanov dhe të tjerë., 2018)

"Lidhur me presionet, deri sa isha redaktor nuk kishte ndonjë rast serioz, i cili do të kërkonte mbrojtje. Prej disa redaktorëve u kërkua të inçizohet me çdo kusht një kompani e caktuar ose bashkëbisedues. Në vitin 2015 më i theksuar ishte presioni prej vetë redaktorëve të lajmeve dhe të emisioneve se sa prej strukturave politike. Unë derisa kam qenë redaktor nuk kam pasur rast për sulm përveç rëfimeve të dy korrespondentëve se njëri prej drejtorëve i kishte shantazhuar, ose do të punonin edhe për televizionet e reja rajonale ose nuk do merrnin marrëveshje pune as me RTM. Të gjithë pranuan të punojnë për televizionet rajonale, përveç Olivera Zhezhoves nga Shtipi".⁶

⁵ Igor Stojanov, Toni Mlhajlov, Ivan Bojaxhiski, 2018, "Gjendja socio-ekonomike e gazetarëve në Maqedoninë Lindore – storie hulumtuese, SHGM dhe Klubi Rinor – Shtip.

⁶ Intervistë me Donka Dolgoska, ish redaktor i redaksisë së korrespondentëve në RTM1, 31.5.2019

Radio maqedone në gjuhën maqedone

RMA ka tre korrespondent:

- Në Kumanovë (mbulon edhe Kratovën);
- Në Kriva Pallankë dhe;
- Strumicë (mbulon edhe Gjevgjelinë, Dojranin, Bogdancin, Vallandovën dhe Radovishin).

Korrespondentët janë më vendime për vendet e punës "gazetar 2" me të ardhura mujore prej 23.140 denarë, ndërsa kompensimi për transport është përlogaritur në pagën bruto. Për relacione më të gjata sigurohen urdhëresa për udhëtim.

Kjo do të thotë se korrespondenti nga Strumica duhet vetëm të përkujdeset se si do të arrijë në ngjarrjet në Radovish, Dojran, Gjevgjeli ose Bogdanci (nëse do të shfrytëzojë makinë personale ose autobus). Në situatë më të lakmueshme është korrespondenti i Kriva Pallankës, sepse mbulon vetëm qytetin, ndërsa korrespondenti i Kumanovës e ka patjetër në regji të veten të udhëtojë deri në Kratovë.

Në bazë të gjitha këtyre të dhënave, konstatohet se Radio televizioni maqedon në asnjë aspekt nuk e përmbush obligimin për mbulimin e thuaja gjysmës së territorit të vendit.

Me vetëm tre të punësuar si korrespondent të Radios maqedone, pa asnjë qendër korrespondenture, teknik, kameraman, mund lirisht të thuhet se nuk ka as kushte minimale për mbulimin elementar me informacione nga mbarë rajoni.

Gjendja me korrespondent të RTMV2, Servisi i dytë programor

Korrespondentët e Servisit të dytë programor (RTMV2) raportojnë në të njejtën kohë edhe për radion. Ka pesë korrespondentë edhe atë:

- **Tetova** – gazetar dhe kameraman;
- **Gostivari** – gazetar pa kameraman;
- **Kërçova** – gazetar pa kameraman;
- **Dibra** – gazetar pa kameraman;
- **Kumanova** – gazetar.

"Të gjithë janë në marrëdhënie të rregulltë pune dhe me vendim për vendin e punës "gazetar 3" me pagë të rregullt mujore prej 19. 500 denarë, pa shtesat për stazhin e punës. Ata nuk marrin kompensime shtesë për shpënzime për benzinë, internet ose telefon. Kameramani i vetëm i Tetovës është me vendim për vendin e punës "kameraman 3" me pagë mujore prej 16.500 denarë. Duke krahasur me gjendjen para 5,10 apo 15 vitesh, gjendja është përkeqësuar, sepse mungojnë korrespondent në Strugë-Dhër dhe në Prishtinë, ku kishte paraprakisht".⁷

Lidhur me pasjesisjen dhe makinat, asnjë prej këtyre korrespondentëve nuk ka makinë zyrtare, kameramani prej Tetove ka kamer private. Nuk kanë zyra, as telefona ose internet që ua mbulon RTM. Korrespondentët nga Kumanova dhe Dibra përdorin kamera private, materialet i dërgojnë prej kompjuterëve të tyre privat, ndërsa ata që nuk kanë kamera materialet i sigurojnë dhe i dërgojë si dinë dhe mundin duke u gjindur përmes mediave tjera elektronike.

Asnjë prej korrespondentëve nuk ka zyrë, e as vend pune nga RTM, si ishte rasti para pasëmbëdhjetë vitesh.

⁷ Intervistë me Migena Gorenc, redaktor përgjegjës i Servisit të dytë programor RTMV2, 3.06.2019..

"Shumica e tyre nuk ndjekin trajnime speciale, e as që kanë marrë udhëzime speciale lidhur me sigurinë e tyre personale, si dhe rezistencën ndaj ndikimeve dhe presioneve. Korrespondentët nga Kumanova, Gostivari dhe Kërçova kanë pasur disa trajnime, të cilat nuk kanë qenë të organizuara nga RTM, ndërsa korrespondenti nga Dibra dhe Tetova nuk kanë ndjekur asnjë trajnim".⁸

"Në bisedë me një anëtar të Kishillit programor të RTM, ishte nënvizuar se aktualisht RTM ka punësuar 12 korrespondentë që punojnë për RTM1 dhe RTM2, dhe se këtë vit RTM ka shpallur konkurs për pranimin e korrespondentëve të ri. Megjithatë, ky numër ende është i ulët, nëse merret parasysh se do të hapet edhe një kanal i ri televiziv me program të plotë në gjuhën shqipe".⁹

Për nevojat e këtij hulumtimi nga SHGM qenë dërguar shkresa deri te pesë televizionet kombëtare private me këtë pyetje:

Cili është numri i përgjithshëm i korrespondentëve nëpër rajone, me çfarë marrëveshjesh janë të angazhuar dhe sa është paga e tyre/honorari (gjendja aktuale maj 2019)?

Asnjë prej këtyre televizioneve kombëtare nuk ju përgjigj kërkesës së SHGM prandaj informacionet për numrin e korrespondentëve të angazhuar ose të punësuar nga pesë radiodifuzerët më të mëdhenjë nuk përmbanë ky hulumtim.

⁸ Intervistë me Migena Gorenca, redaktor përgjegjës i Servisit të dytë programor RTMV2, 3.06.2019.

⁹ SHGM, Rrjeti i korrespondentëve (gjendja dhe analiza e serviseve publike të Ballkanit perëndimor dhe në Bashkimin Evropian, marrë nga www.znm.org.mk/анализи-и-публикации/дописничка-мрежа-состојба-и-анализа-н/

V. MASA PËR PËRMIRËSIMIN E GJENDJES SË KORRESPONDENTËVE

Analizat na tregojnë se ka nevojë të shtuar për legjislacion me të cilin do t'i imponohej të gjitha mediave kombëtare të angazhojnë korrespondentë. Në kohën kur mediat janë vunerabël, dhe në kohën kur janë të goditura nga dezinformacionet, imponohet nevoja për raportim të saktë, në kohë dhe gjithëpërfshirës, me qëllim opinionin të fitojë pasqyrë të plotë, e cila nuk do çojë në lajthitje për shkak të ofrimit të informacioneve në mënyrë jo të plotë, të gabuar, spekulative apo të vonuar.

E rëndësishme është të theksohet se mediat duhet patjetër të jenë profesionale dhe të përgjegjshme, dhe për këtë, e nevojshme është edukimi i vazhdueshëm i të punësuarve, në drejtim të zhvillimit të vazhdueshëm të aftësive të tyre profesionale dhe përparimin e standardeve të punës. Mediat duhet patjetër të punësuarit e tyre t'i edukojnë me trajnime të përshtatshme.

Rajonet, respektivisht brendia e vendit është njesoj e rëndësishme për zhvillimin e rrjetit të korrespondentëve dhe të gjenjdes së mediave. Për shkak të kësaj paraqitet nevoja për rritjen e financave që ndahen për korrespondenturat, për të forcuar pavarësinë e korrespondentëve, por njëkohësisht t'i inkurajojnë të rinjët jashtë kryeqytetit të mos emigrojnë dhe të merren me gazetari.

Mediat patjetër vazhdimisht të punojnë për përparimin e gjendjes së të punësuarve, respektivisht të rritjes dhe zhvillimit të tyre profesional. Kjo është vendimtare për rritjen e besimit të publiku, veçanërisht tani në kohën e epokës dixhitale, kur imponohen trende të reja që mund të çenojnë gazetarinë dhe veprimtarinë e mediave. Prandaj cilësia e mediave, oferta e përmbajtjes së tyre është shumë e rëndësishme. Në këtë drejtim, gazetarët, ndërsa prej tyre edhe korrespondentët janë resurs i rëndësishëm, të cilit duhet t'i kushtohet kujdes, për të përmirësuar efikasitetin në punën e tyre.

Centralizmi i informacioneve të plasuara në opinion sjellë opinionin në lajthitje për situata të ndryshme dhe zhvillime në pjesët tjera të vendit. Kështu rrënohen parimet themelore të gazetarisë. Shtesë, legjislacioni edekuat për angazhimin e detyruar të gazetarëve nga periferia e vendit, do të kontribuojë edhe për uljen e ndikimit dhe presioneve nga qendra të ndryshme të ndikimit.

Krahas obligimit për angazhimin e detyruar të korrespondentëve dhe krijimin e rrjetit të korrespondentëve, nevojitet edhe legjislacion, sipas të cilit mediat do të sigurojnë kushte të përshtatshme për punën e korrespondentëve, si dhe furnizimin e tyre me pajisjen themelore të punës.

Rrjeti i korrespondentëve dhe trajtimi i korrespondentëve luan një rolë të rëndësishëm lidhur me përparimin e identitetit kulturor të vendit në përgjithësi, por edhe të rajoneve të tij, veçanërisht. Ata janë, poashtu, të rëndësishëm për mbrojtjen dhe ruajtjen e gjuhës, traditës dhe të bashkësive lokale, nxitjen e dialogut të hapur kulturor të gjithë qytetarëve, në drejtim të përparimit dhe forcimit të raporteve midis bashkësive të ndryshme të vendit dhe jashtë saj.

Me qëllim përmirësimin e gjenjdes, SHGM rekomandon një seri masash me të cilat do të përkrahen mediat profesionale, do të sigurohet gazetari e pavaruar cilësore hulumtuese, duke prodhuar përmbytje ku nuk hyjnë korrespondentët, për të kënaqur nevojat e grupeve të ndryshme të interesit nga brendia e vendit, të cilët aktualisht nuk janë të përfaqësuar sa duhet në media. Në këtë kontekst, prioritetet e SHGM janë të përqëndruara në mbështetjen e arsimit të përshtatshëm joformal dhe trajnime. Shtesë, SHGM, krijon kushte për punën cilësore të gazetarëve hulumtues dhe pritet se do të mundësohen kushte korrespondentët të inkuadrohen në masë të duhur në profesion.

Në pjesën për Radio televizionin maqedon dhe MIA:

1. Drejtuesit e ri të RTMV duhet të sigurojnë zhvillim të korrespondenturave në të gjitha rajonet në Republikën e Maqedonisë së Veriut; të paktën nga dy gazetarë dhe dy kameraman dhe montazher ose 16 gazetarë dhe po aq kameraman dhe mantazher. E rëndësishë së vaçantë është që gazetarët dhe kameramanët të jenë të punësuar me orar të plotë pune, me marrëveshje për kohë të pacaktuar.
2. Nevojitet MIA të bëjë vlerësimin se sa korrespondentë i duhen për mbulimin efikas të temave me karakter lokal dhe të gjithë ato të punësohen me orar të plotë pune, me marrëveshje për kohë të pacaktuar, poashtu edhe në rastin e RTM.
3. Drejtuesit e ri të RTMV, në bashkëpunim me MIA, duhet në çdo rajon të sigurojnë hapësira dhe mjete pune për korrespondenturat duke inkuadruar të paktën nga një makinë, ndërsa korrespondentëve të servisit radioviziv publik dhe të Agjencisë kombëtare të lajmeve, të paktën tetë qendra të korrespondenturave.

Në pjesën e mediave të shkruara

4. Nevojitet që gazetatat ditore në nivel kombëtarë të kenë rrjetë të zhvilluar të korrespondentëve, sepse në janar të këtij viti finansiarisht janë të përkrahur nga qeveria, që do të thotë se të paktën të kenë nga tre korrespondentë në marrëdhënie të rregulltë pune.

Në pjesën e televizioneve kombëtare terestriale dhe kabllore:

5. Radiodifuzerët kombëtare me liçencë terestriale (pesë televizionet me format të përgjithshëm) që emitojnë në nivel kombëtarë është e nevojshme të kenë rrjetë të gjerë korrespondentësh sepse ata janë televioznet e vetme krahas MRTV që emitojnë në të gjitha viset e vendit. Përveç të drejtave që këto televizione i fitojnë me atë që emitojnë në mbarë

territorin kanë edhe obligime të informojnë për tema me rëndësi lokale dhe rajonale. Poashtu, duhet të sigurohen mjete dhe kushte adekuate për punë. Prandja, duhet të bëhen ndryshime dhe plotësime të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapsinore, finansiare dhe kadrovike për marrjen e liçencës për emitim të radios dhe televizionit edhe atë në kapitullin VI, neni 22 që ka të bëjë me numrin dhe strukturën e të punësuarve. Këto ndryshime duhet të garantojnë se nga minimum 30 gazetarë të punësuar në televizionet terestriale, të paktën 4 duhet të jenë korrespondentë me orar të plotë pune, respektivisht prej 10 gazetarëve të punësuar në televizionet kablllore, të paktën 2 duhet të jenë korrespondentë me orar të plotë pune.

Rekomandime të përgjithshme

6. Nevojitet edukim i vazhdueshëm intern në redaksitë e mediave për korrespondentët e tyre, veçanërisht në përdorimin e teknologjive të reja dhe ndjekjes së trendeve (për të inçizuar dhe montuar kontributet vetë, përdorimin e telefonave celular dhe aplikacione gjate raportimit dhe të ngjashme).
7. Nevojitet arsimin i vazhdueshëm joformal nga ana e organizatave të esnafit lidhur me standardet profesionale, njohjen me dezinformatat, respektimin e të drejtave të autorit, etj.
8. Bashkësia e donatorëve ndërkombëtarë duhet të ketë më shumë interes dhe mirëkuptim për nevojat e korrespondentëve dhe të ketë programe për ndihmë finansiare për zhvillimin e tyre profesional.



Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

www.znm.org.mk

